



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d)si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.05.2013, nxjerr këtë :

**V E N D I M**

- I. Mbyllët rasti me nr. AKK-03-3918/12, për **znj. Ardita Baraku, Kryeinspektore shëndetësore, në Ministrinë e Shëndetësisë**, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas informatës së marrë nga një informatorë anonim në adresë të AKK-së, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-214/13, që për trajtim ka pasur Zyrtaren e Lartë, znj. Ardita Baraku, Kryeinspektor Shëndetësore, në Ministrinë e Shëndetësisë.

Gjatë zhvillimit të procedurës fillestare është dyshuar se zyrtarja e lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si Kryeinspektorë Shëndetësore, në Ministrinë e Shëndetësisë, njëkohësisht është e angazhuar edhe në një tjetër veprimtari.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 20.02.2013, e ka njoftuar zyrtaren e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, znj Ardita Baraku, pasi ka kontaktuar me zyrtaret e Agjencisë ka kërkuar të takohemi dhe të bisedojmë rreth çështjes së ngritur, është organizuar takimi me znj. Baraku, dhe e kemi njoftuar për fillimin e hetimeve lidhur me gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Gjatë takimit zyrtarja në fjalë e ka

potencuar se ushtron funksionin e Krye inspektore Shëndetësore ne Ministrin e Shëndetësisë, dhe njëkohësisht është duke e vazhduar shkollimin specialistik postdiplomik, sipas kontratës mbi Financimin e Edukimit Specialistik Post-diplomik me Ministrin e Shëndetësisë.

Gjatë prezantimit të provave dhe argumenteve, zyrtarja në fjalë është arsyetuar se, pozita si Krye inspektore Shëndetësore, nuk mund të shkaktoj situatë të konfliktit të interesit me angazhimin e saj si specializante. dhe nuk mendon që gjendet në situatë të konfliktit të interesit, pasi që konsideron se angazhimi në ngritje profesionale nuk bie në kundërshtim me asnjë normë juridike në fuqi.

Agjencia kundër Korrupsionit duke u bazuar në gjendjen reale si dhe duke marrë për bazë : Kontratën e Punës, Përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive në punë, si dhe duke u bazuar ne neni 77,78 të Udhëzimit Administrativ për Shëndetësi Nr.08/2011, dhe nenin 35 te Ligjit për Shërbimin Civil dhe Ligjin Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Konstaton se:

Ushtrimi i funksionit si Kryeinspektorë Shëndetësorë në Ministrinë e Shëndetësisë nga znj. Ardita Baraku, dhe angazhimi i saj për shkollim specialistik postdiplomik, nuk paraqesin mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, dhe nuk është në gjendje të konfliktit të interesit, mirëpo gjithmonë duhet zbatuar neni 7 pikat 1,2,3,4,5,6,7, të Ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit te Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Andaj u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Zyrtari përgjegjës

Hasan Preteni  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

